

BASHKIA E TIRANËS
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Drejtuar: Bashkimit të Operatorëve ekonomik “V.A.S Konstruksion” & “Sterkaj” shpk;
Adresa: Blv."Bajram Curri", mbrapa pallateve Agimi, Pallati 7/1B, Njesia Bashkiake Nr. 5, Kati 2 Tiranë.
Rruga "Gjin Bue Shpata", pallati "Binjaket", hyrja 1, kati 5, ap.14/1, Tiranë

Procedura e prokurimit: “Procedurë e Hapur” “Ndërtimi i segmentit rrugor nga rreth-
rrotullimi Mullet deri te ura në fshatin Qeha”.

Numri i referencës së procedurës: REF-12537-03-06-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: Qëllimi i kontratës është: “Ndërtimi i segmentit rrugor nga
rreth-rrotullimi Mullet deri te ura në fshatin Qeha”.

Fondi limit: 208,243,180.9 (dyqind e tetë milion e dyqind e dyzet e tre mijë e njëqind e tetëdhjetë
pikë nëntë) lekë pa TVSH.

Kohëzgjatja e kontratës: 9 (nëntë) muaj kalendarike kalendarike duke nisur nga dita e lidhjes së
kontratës.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: 08.04.2019, ora 11:00.

Publikime të mëparshme: (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: Buletini i Njoftimeve
Publike Nr. 10 datë 11.03.2019.

Kriteret e përzgjedhjes së fituesit: çmimi më i ulët ☒ oferta ekonomikisht më e favorshme ☐

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik “Curri” shpk **NUIS J67902718S**
Vlera e ofertës = 140,380,077 (njëqind e dyzet milion e treqind e tetëdhjetë mijë e shtatëdhjetë e
shtatë) lekë pa TVSH.

2. Operatori ekonomik “4 AM” sh.p.k **NUIS K92005016L**
Vlera e ofertës = 143,549,535 (njëqind e dyzet e tre milion e pesëqind e dyzet e nëntë mijë e
pesëqind e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

3. Operatori ekonomik “Eurondertimi 2000” shpk **NUIS K02003001O**
Vlera e ofertës = 143,934,777.63 (njëqind e dyzet e tre milion e nëntëqind e tridhjetë e katër mijë
e shtatëqind e shtatëdhjetë e shtatë pikë gjashtëdhjetë e tre) lekë pa TVSH.

4. Bashkimi i Operatorë ekonomik “V.A.S Konstruksion” shpk & “Sterkaj” shpk
NUIS J68310708M & NUIS L61322023P

Vlera e ofertës = 158,033,075.03 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e tridhjetë e tre mijë e shtatëdhjetë e pesë pikë zero tre) lekë pa TVSH.

5. Operatori Bashkimi i Operatorë ekonomik “Agi Kons” shpk & BE-IS shpk

NUIS K 21622001 M & NUIS K71412003A

Vlera e ofertës = 158,152,462 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e njëqind e pesëdhjetë e dy mijë katërqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.

6. Operatori ekonomik “Arifaj” shpk

NUIS J76418907K

Vlera e ofertës = 162,146,112.70 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e njëqind e dyzet e gjashtë mijë e njëqind e dymbëdhjetë pikë shtatëdhjetë) lekë pa TVSH.

7. Bashkimi i Operatorëve ekonomikë “Alba Konstruktion” shpk & “Ed Konstruktion” shpk & “Spektri” shpk

NUIS J61812013R, NUIS J62903555F, & NUIS K61625001I

Vlera e ofertës = 162,248,654.20 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër pikë njëzet) lekë pa TVSH.

8. Operatori ekonomikë “Ante Group” shpk

NUIS J62904100D

Vlera e ofertës = 165,705,424.50 (njëqind e gjashtëdhjetë e pesë milion e shtatëqind e pesë mijë e katërqind e njëzet e katër pikë pesëdhjetë) lekë pa TVSH.

9. Operatori ekonomikë “Salillari” Shpk

NUIS J62903125G

Vlera e ofertës = 170,748,143 (njëqind e shtatëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e tetë mijë e njëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH.

10. Operatori ekonomikë “Gjiguria” Shpk

NUIS J62903456H

Vlera e ofertës = 170,749,261 (njëqind e shtatëdhjetë milion e shtatëqind e dyzet e nëntë mijë e dyqind e gjashtëdhjetë e një) lekë pa TVSH.

11. Bashkimi i operatorëve ekonomik “Sireta 2F” & “Varaku E” shpk

NUIS K51501008J & NUIS J61902509S

Vlera e ofertës = 174,444,444 (njëqind e shtatëdhjetë e katër milion e katërqind e dyzet e katër mijë e katërqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH.

12. Operatori ekonomik “2 T” shpk

NUIS K01731001M

Vlera e ofertës = 176,244,804.75 (njëqind e shtatëdhjetë e gjashtë milion e dyqind e dyzet e katër mijë e tetëqind e katër pikë shtatëdhjetë e pesë) lekë pa TVSH.

Janë skualifikuar Operatorët ekonomik të mëposhtëm:

Përkatesisht për arsyet e mëposhtme:

1. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Curri” shpk

NUIS J67902718S

- Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson gjurmën “b” të pikës 4 të Kapaciteti Teknik Dokumentave Standarte të Tenderit: *“List pagesat e punonjesve sipas formatit qe kerkohet*

nga legjislacioni ne fuqi per periudhen Shkurt 2018 - Shkurt 2019, shoqëruar me formularët e deklarimit te pagesave për sigurimet shoqërore dhe shendetesore, **pasi nuk ka paraqitur urdhër pagesat për shlyerjen e detyrimeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhen Shkurt 2018 - Shkurt 2019.**

- Komisioni i Vlerësimit të Ofertave, pasi verifikoi dokumentacionin shoqërues për stafin teknik, konstatoi se shoqëria “Curri” shpk nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion që të provojë se ka të punësuar 1 (një) Inxhinier Ndërtimi (Profili transport), çka bie në kundërshtim me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
 - Operatori ekonomik “Curri” shpk ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 3 (tre) punonjës teknik ndërtimi. Gjate verifikimit te dokumentacionit u konstatua se per dy nga punonjësit e deklaruar, Dëshmia e Kualifikimit te sigurimit teknik nuk është e kategorisë IV. Për sa më lart, Operatori ekonomik nuk plotëson Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 8, ku përcaktohet se: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 3 (tre) punonjës teknik ndërtimi të vertetuar me kontrata e pune te vlefshme; diplomë përkatëse, **deshmi kualifikimi te sigurimit teknik me kategori IV (të vlefshme)**, si dhe te figurojne ne listpagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit.*
 - Operatori ekonomik ka deklaruar se ka të punësuar pranë shoqërisë 3 (tre) “punonjës Hekurthyes”, nga 4 (katër) të kërkuar, cka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 9.
 - Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson pikën 9 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të Tenderit: *“Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar punonjës të pajisur me dëshmi kualifikimi sigurimit teknik, (të vlefshme)..../ 4 (katër) punonjës karpentier “ pasi nga 5 (pesë) punonjës karpentier të deklaruar, për dy prej tyre dëshmitë e kualifikimit të sigiurimit teknik, rezultojnë të pavlefshme, konkretisht data e përfundimit të vlefshmërisë 26.3.2019 dhe 27.3.2019.*
 - Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson gërmën “a” të pikës 18 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet.....”* pasi për dy autopompat e deklaruar në dokumentacionin e paraqitur mungon Akti i Pronësisë.
 - Operatori ekonomik “Curri” shpk nuk plotëson gërmën “a” të pikës 18 të Kapacitetit teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: *“Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet.....”* pasi është paraqitur dokumentacion për 4 (katër) autobetoniere, ku për 3 (tre) prej tyre nuk janë paraqitur Aktet e Pronësisë.
 - Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Curri” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.
- 2. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “4 AM” shpk NUIS K92005016L**
- Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të preventivit të paraqitur nga Operatori ekonomik “4 A-M” shpk, konstatoi se tek Zëri Nr. 3 “Mbushje me material filtrues prapa mureve mbajtës (për muret pas ballnave)” në kategorinë Rruga “Nënstruktura”, është bërë ndryshimi i sasisë së punës që do të kryhet të parashikuara nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ne Preventivin e paraqitur nga Ofertuesi cka bie në kundërshtim me Udhëzimet për

Operatorët Ekonomikë të përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, Seksioni 2, Përlllogaritja e ofertës ekonomike. Në këtë mënyrë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk e ka marrë në konsideratë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “4 A-M” shpk duke e shpallur të pavlefshme. Duke qënë se vëllimi i punimeve të specifikuara në projekt është i pandryshueshëm, rrjedhimisht ofertuesi është i detyruar të pranojë sasisë e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe mbi to të ofertojë.

- Operatori ekonomik “4 A-M” shpk nuk plotëson pikën 8 të kapaciteti Teknik të Kritereve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar 3 (tre) punonjës teknik ndërtimi të vertetuar me kontrata e pune të vlefshme; diplomë përkatëse, deshmi kualifikimi të sigurimit teknik me kategori IV (të vlefshme)....” pasi asnjë nga teknikët e ndërtimit të paraqitur nuk janë me kategorinë IV.
- Operatori ekonomik “4 A-M” shpk nuk plotëson pikën 18 të kapaciteti Teknik të Kritereve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/ Autobot Uji” pasi mjeti Autobot Uji me targë AA165SB rezulton i angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me Objekt: “Ndërtimi i rrugëve të bllokut pranë ish Astirit” e cila nuk i ka përfunduar efektet ligjore-teknike-financiare.
- Operatori ekonomik “4 A-M” shpk nuk plotëson pikën 18 të kapaciteti Teknik të Kritereve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/ Autopompë Betoni” pasi mjeti Autopompë betoni me targë AA887VL rezulton i angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me Objekt: “Ndërtimi i rrugëve të bllokut pranë ish Astirit” e cila nuk i ka përfunduar efektet ligjore-teknike-financiare.
- Operatori ekonomik “4 A-M” shpk nuk plotëson pikën 18 të kapaciteti Teknik të Kritereve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/fadromë me goma/2(dy)copë” pasi nga 3 fadroma me goma të deklaruara në Shtojcën 10, 2 prej tyre respektivisht me targë AGMT64 dhe AHMT05 rezultojnë të angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me Objekt: “Ndërtimi i rrugëve të bllokut pranë ish Astirit” e cila nuk i ka përfunduar efektet ligjore-teknike-financiare.
- Operatori ekonomik “4 A-M” shpk nuk plotëson pikën 18 të kapaciteti Teknik të Kritereve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/Autovinc/2(dy)copë” pasi nga 3 mjete autovinc të deklaruara në Shtojcën 10, 2 prej tyre respektivisht me targë AA465PC dhe AA718VL rezultojnë të angazhuar në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me Objekt: “Ndërtimi i rrugëve të bllokut pranë ish Astirit” e cila nuk i ka përfunduar efektet ligjore-teknike-financiare.
- Operatori ekonomik “4 A-M” shpk nuk plotëson pikën 18 të kapaciteti Teknik të Kritereve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/ Autobitumatrice” pasi mjeti Autobitumatrice me targë AA568SM **rezulton i angazhuar** në kontratën e lidhur me Bashkinë Tiranë me

Objekt: “Ndërtimi i rrugëve të bllokut pranë ish Astirit” e cila nuk i ka përfunduar efektet ligjore-teknike-financiare.

- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për aftësinë teknike të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “4 AM” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

3. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk. NUIS K02003001O

- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk plotëson piken 4, të Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik: “*Operatorët Ekonomik duhet kenë të punësuar: “Një punësim mesatar i të paktën 90 (nëntëdhjetë) personave, për periudhën Shkurt 2018 - Shkurt 2019 të vërtetuar me...”*”. pasi për periudhën e sipërcituar rezulton një punësim mesatar prej 63 (gjashtëdhjetë e tre) punonjësish, pra më pak sesa ai i kërkuar.
- Pas verifikimeve të dokumentacionit të paraqitur për stafit teknik, u konstatua se nuk deklaruar të punësuar pranë shoqërisë “Eurondërtimi” shpk Inxhinier Ndërtimin (profili transport), çka bie në kundërshtim me Dokumentat Standarte të Tenderit, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 5.
- Operatori ekonomik “Eurondërtimi 2000” shpk nuk është i pajisur me licencën profesionale nga Qendra Kombëtare e Liçensimit (QKL) Kodi III.2.B, çka bie në kundërshtim me me DST, Kriteret e Veçanta të Kualifikimit, Kapaciteti Teknik, pika 17.

4. Oferta e paraqitur nga Bashkimi i Operatorë ekonomik “Agi Kons” shpk & BE-IS shpk NUIS K 21622001 M & NUIS K71412003A

- Shoqëria “BE-IS” shpk nuk plotëson pikën 4 të Kapacitetit Teknik të Dokumentave Standarte të tenderit: “*Një punësim mesatar i të paktën 90 (nëntëdhjetë) personave, për periudhën Shkurt 2018 - Shkurt 2019 të vërtetuar me....*”, pasi referuar Akt-Marrëveshjes për Bashkepunim të Përkohshëm Nr. 1770.Rep, Nr. 670.Kol, datë 05.04.2019, ky Operator duhet të ketë në dispozicion për kontratën objekt prokurimi 46 (dyzet e gjashtë) punonjës por referuar kontratave të nënshkruara midis operatorit ekonomik dhe Bashkisë Tiranë me objekt: 1. “Rikualifikim urban i Bllokut Nr. 1 (Lapraka) kufizuar nga rrugët “Don Bosko” – “Shinat e Trenit (Filanto) – “Turhan Pashë Përmeti” – “Ibrahim Pashë Bushatlliu” – “Lord Bajron” – “Riza Cuka” – “Learton Vathi” – “Pandi Dardha” – “Dritan Hoxha”; 2. “Ndërtimi i rrugëve ”Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza I”; 3. “Ndërtimi i rrugëve ”Migjeni dhe Kadri Roshi” në Njësinë Administrative Kashar, Faza II”; 4. “Rehabilitim i rrugës dhe qendrës së lagjes Sheheler”, të cilat nuk i kanë përfunduar efektet tekniko-financiare, si dhe referuar diferencës midis numrit të punonjesve të anagazhuar në keto kontrata dhe punësimit mesatar të operatorit ekonomik rezulton një numër i pamjaftueshëm punonjësish.

5. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomik “Arifaj” shpk. NUIS J76418907K

- Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk plotëson pikën 5 të kapaciteti Teknik të Kriterëve të Veçanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatorët ekonomik pjesëmarrës duhet të kenë të punësuar staf teknik për kryerjen e të gjitha punimeve në këtë objekt

.....inxhinier gjeolog” **pasi për inxhinierin gjeolog diploma është paraqitur fotokopje** cka bie në kundërshtim me përcaktimi e Dokumentave Standarte të Tenderit: “Të gjithë dokumentat duhet të jenë origjinalë ose kopje të noterizuara të tyre. Rastet e mos-dorëzimit të një dokumenti, ose të dokumentave të rreme e të pasakta, konsiderohen si kushte për skualifikim”.

- Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk plotëson pikën 10 të kapaciteti Teknik të Kritereve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) Eskavatorist, 2 (dy) Buldozerist, 3 (tre) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmi e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit” pasi ka paraqitur dokumentacion për **2 Automakinist nga 3 të kërkuar.**
- Operatori ekonomik “Arifaj” shpk nuk plotëson pikën 18 të kapaciteti Teknik të Kritereve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutim in e kontratë (Shtojca 10)/ Fadromë me goma/ 2 goma” **pasi nga 2 (dy) fadroma të kërkuar njëri është paraqitur me faturë tatimore dhe jo me dokumentacionin e kërkuar.**
- Sa më lart, në mbështetje të Nenit 46, pika 1, gërma “b” të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe referuar Kreut III, Seksioni II, Neni 26, pika 8, gërma “c” të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), të cilat parashikojnë kualifikimin për **aftësinë teknike** të kandidatëve ofertues, Operatori ekonomik “Arifaj” shpk, referuar Shtojcës 10 nuk ka aftësinë e duhur teknike për realizimin me sukses të kontratës.

6. Oferta e paraqitur nga Operatori ekonomikë “2 T” shpk NUIS K01731001M

- Gjatë shqyrtimit dhe vlerësimit të preventivit të paraqitur nga Operatori ekonomik “2 T” shpk, konstatoi se tek Zëri Nr. 16 “F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm (per ballnat)” dhe zeri 18 “F V hekur betoni periodik, Ç - 5, Ø > 12mm (per muret pas ballnave)” në kategorinë Rruga “Nënstruktura”, janë bërë ndryshime në sasisë së punës që do të kryhet të parashikuara nga Autoriteti Kontraktor, Bashkia Tiranë, ne Preventivin e paraqitur nga Ofertuesi cka bie në kundërshtim me Udhëzimet për Operatorët Ekonomikë të përcaktuar në Dokumentat Standarte të Tenderit, Seksioni 2, Përlllogaritja e ofertës ekonomike. Në këtë mënyrë Komisioni i Vlerësimit të Ofertave nuk e ka marrë në konsideratë ofertën e paraqitur nga operatori ekonomik “2 T” shpk duke e shpallur të pavlefshme. Duke qënë se vëllimi i punimeve të specifikuara në projekt është i pandryshueshëm, rrjedhimisht ofertuesi është i detyruar të pranojë sasisë e përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor dhe mbi to të ofertojë.
- Operatori ekonomik “2 T” shpk nuk plotëson pikën 10 të kapaciteti Teknik të Kritereve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Operatori ekonomik duhet të ketë të punësuar minimalisht 3 (tre) Eskavatorist, 2 (dy) Buldozerist, 3 (tre) Automakinist, për të cilët duhet të paraqitet kontrata e punës e vlefshme, dëshmi e drejtimit (të vlefshme), lëshuar nga institucionet përkatëse si dhe të figurojnë në list-pagesat e shoqërisë për të paktën 3 (tre) muajt e fundit”, **pasi Automakinistit N. L i ka mbaruar vlefshmeria e Deshimse se Drejtimit me date 25.10.2017.**

- Operatori ekonomik “2 T” shpk nuk plotëson pikën 18 të kapaciteti Teknik të Kriterëve të Vecanta të Dokumentave Standarte të Tenderit: “Dëshmi për mjetet e pajisjet teknike, që ka në dispozicion apo mund ti vihen në dispozicion operatorit ekonomik, që nevojiten për ekzekutimin e kontratë (Shtojca 10)/ Autopompe Betoni/ 1 cope” **pasi nuk ka deklaruar në shtojcen Nr 10 se disponon mjetin Autopompe betoni.**
- Operatori ekonomik “2T” shpk ka deklaruar se disponon 2 Autobetoniere përkatësisht me targa AA679NJ dhe AA942SS. Për te dy mjetet e sipercituara nuk janë paraqitur çertifikata për transport mallrash brenda vendit, çka bie në kundërshtim me pikën 18/a ku citohet se:” *Për mjetet që shënohen në regjistra publikë duhet të paraqitet: a) dokumenti që verteton regjistrimin e mjetit (aktin e pronësisë) b)leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik; d)siguracionin e mjetit, (i vlefshëm); e)çertifikatën për transport mallrash brenda vëndit, (e vlefshme).* Për mjetet e siguruara me qera duhet të paraqitet: a)dokumenti qe verteton regjistrimin e tij (aktin e pronësisë); b) leje qarkullimi; c)çertifikatën e kontrollit teknik, d)siguracionin e mjetit,(i vlefshëm); **e) çertifikatën e për transport mallrash brënda vëndit, (e vlefshme).** Mjetet të shoqerohen me kontraten perkatese te qerases/furnizimit, e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates, objekt i ketij prokurimi. Në rastin e mjeteve te tjera duhet te jene aktet e ç’doganimit ose faturat tatimore te blerjes.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë **Bashkimin e Operatorëve ekonomik “V.A.S Konstruksion” shpk & “Sterkaj” shpk** me adresë: Blv."Bajram Curri", mbrapa pallateve Agimi, Pallati 7/1B, Njesia Bashkiake Nr. 5, Kati 2 Tiranë dhe me adrese: Rruga "Gjin Bue Shpata", pallati "Binjaket", hyrja 1, kati 5, ap.14/1, Tiranë, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej **158,033,075.03 (njëqind e pesëdhjetë e tetë milion e tridhjetë e tre mijë e shtatëdhjetë e pesë pikë zero tre) lekë** pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë Bashkisë së Tiranës, Sheshi Skënderbej, Nd. 2, Kodi Postar 1001, Tiranë, Shqipëri sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes së këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, oferta e të cilit është dorëzuar me një vlerë të përgjithshme prej **162,248,654.20 (njëqind e gjashtëdhjetë e dy milion e dyqind e dyzet e tetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e katër pikë njëzet) lekë** pa TVSH, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë: 19.04.2019

Gjatë afatit ligjor për pritjen e ankesave nga shoqëritë pjesëmarrëse në tender në mbështetje të Nenit 63 të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar) si dhe në bazë të Kreut X, Neni 78 të VKM-së Nr. 914 datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar), pranë Autoritetit Kontraktor, Bashkia Tiranë, është paraqitur Formulari i Ankesës nga Operatori ekonomik “Curri” shpk, hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën Nr. 17379. Prot. datë 24.04.2019,(administruar në dosjen e prokurimit), në lidhje me vlerësimin për procedurën

e prokurimit me objekt: “Ndërtimi i segmentit rrugor nga rreth-rrotullimi Mullet deri te ura në fshatin Qeha”.

Me marjen e ankesës nga Operatori ekonomik i mësipërm në mbështetje të Ligjit Nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” (i ndryshuar), Neni 63, pika 3 si dhe në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 2 të Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 10709/3 Prot. dt. 24.04.2019 është pezulluar procedura e prokurimit deri në marrjen e një vendimi përfundimtar sipas rregullave të parashikuara nga LPP dhe RRPP. Gjithashtu në mbështetje të Kreut X, Neni 78, pika 6, gërma ”a” të VKM-së Nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, (i ndryshuar) me Urdhërin me Nr. 10709/4 Prot. datë 24.04.2019 u ngrit Grupi i Shqyrtimit të Ankesave, i cili pasi u njoh me pretendimet e Shoqërisë “Curri” shpk konkludoi me mos pranimin e ankesës, duke i kthyer pergjigje me shkresën me Nr. 17379/2 Prot, datë 30.04.2019, (administruar ne dosjen e prokurimit).

Në vijim jemi vënë në dijeni me anë të shkresës me Nr. 32/2. Prot. datë 07.05.2019 hyrë në Bashkinë e Tiranës me shkresën me Nr. 19576. Prot. datë 10.05.2019 se Shoqëria ”Curri” shpk ka ushtruar të drejtën e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, referuar procedurës së prokurimit me objekt: “Ndërtimi i segmentit rrugor nga rreth-rrotullimi Mullet deri te ura në fshatin Qeha”, (administruar ne dosjen e prokurimit).

Komisioni i Prokurimit Publik nëpërmjet Vendimit Nr. 818/1, datë 13.05.2019, hyrë në Bashkinë Tiranë me Nr. 20228 Prot, datë 15.05.2019 i ka kërkuar Autoritetit Kontraktor, Bashkisë Tiranë, pezullim procedure dhe informacion të detajuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Bashkia Tiranë me anë të shkresës me Nr. 20228/1 Prot, datë 17.05.2019 i ka vënë në dispozicion Komisionit të Prokurimit Publik, të gjithë informacionin e kërkuar në lidhje me ecurinë e kësaj procedure prokurimi.

Për sa më sipër, me shkresën “Dërgim Vendimi” me Nr. 377/1 Prot., datë 18.06.2019, hyrë në Bashkinë e Tiranës me Nr. 25272 Prot., datë 20.06.2019 (administruar në dosjen e prokurimit), jemi vënë në dijeni se Komisioni i Prokurimit Publik nuk ka pranuar ankesën e bërë nga shoqëria “Curri” shpk. Në zbatim të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik me Nr. 377/2019 Prot., datë 18.06.2019 Autoriteti Kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshme të procedurës së prokurimit.